ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **NPL KASTRIOTI -24-3397-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Ritender-Programi financiar,menaxherial dhe administrativ si dhe mirembajtja**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Zejnullah Fetahu B.I.**
NUI	**810902876**
Adresa	**Prishtinë, N. Terezë 40a Nr. 2**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044631998**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Zejnullah Fetahu**
Adresa elektronike	**info@cmd-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**29.04.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

CMD ENTERPRISE SERVICE NDËRMARRJA SHËRBYESE PRISHTINË 2010

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ritender-Programi financiar,menaxherial dhe administrativ si dhe mirembajtja

05.04.2024 – Njoftimi për kontratë

12.04.2024 (ora 13;30) – Afati i fundit për dorzimin e tenderëve

19.04.2024, kemi pranuar Vendimin e AK-së, për aktivitetin e prokurimit me njoftimin për eliminimin nga ky aktivitet i Prokurimit.

19.04.2024, kemi kerkuar qasje ne dokumenetet e tenderit.

23.04.2024- Kerkese per rishqyrtim nga N.SH CMD

26.04.2024 – Njoftim mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim DHE Vertetimin mbi vendimin e AK te dates 19.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒ **Jo** ☐

Hapja e tenderit është bere ne vendin e caktuar dhe ne kohen e caktuar ne Njoftimin per kontrate. Procesi i hapjes është zhvilluar konforme Ligjit. Nuk kemi vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

23.04.2024- Kerkese per rishqyrtim nga N.SH CMD

26.04.2024 – Njoftim mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim.

NDËRMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE PRISHTINË 2010

AK, duke mos gjetur ndonjë mangësi në dokumentacionin e prezentuar, edhe pse nuk ka kerkuar dok. shtese per sqarim , nga ana jonë, ka vlerësuar pa kurrfarë kriteri duke shkelur të gjitha dispozitat ligjore në këtë te nenit 59, dhe merr vendimin arbitrar (në fakt skandaloz) për refuzimin dhe eleminimin tone nga ky proces,

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK: NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A., ne tekstin emtejme Autoriteti Kontraktues dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtroi këtë Kërkesë për rishqyrtim te vendimit te AK-se.

1. Njoftimit (Vendimit) të AK-së- NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A, te dates 19.04.2024 ku eshte rekomanduar për shpërblim me kontrate, Operatori ekonomik; "Incormatika Computers SH.P.K. me vlerë totale të tenderit; 8,500.00 euro.

dhe

2. Letrës standarde te eliminimit -Njoftimit për eliminimin nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit

3.Refuzimit te kerkeses per Rishqyrtim , pretendojme dhe mundemi ta deshmojme me fakte qe AK , **NUK** e ka trajtuar me seriozitet kerekesen tone per rishqyrtim , pasi qe fillimisht nuk e ka kerkuar dokumentacion shtese , edhe pas kerkeses sone per Rishqyrtim , ne te cilen i kemi bashkangjitur certifikatat shtese , sipas Listes se stafit , dhe kontratave qe kemi dorzuar ne oferten tone per dorzim te tenderit ,

Kerkesa 1: certifikata per puntoret Aid Muliqi dhe Albin Hetemi e plotesojne kerkesen 1 , certifikata te leshuara nga Cacctus Education partner i certifikuar i Microsoft. dhe AK ne vendimin e vet te refuzimit te kerkeses per Rishqyrtim e MOHON duke thene qe ne NUK i kemi bashkangjitur certifikatat. Ky argument **NUK** qendron

Kerkesa 2: te kete trajner te certifiauar , ku keto certifikata jane te leshuara nga vete OE , dhe ne i kemi bashkangjitur 8 Çertifikata per trajner.

por nuk i ka perfill 7 certifikata valide ku vetem 1 prej tyre e perbush kerkesen e AK, dhe AK nuk i shqyrton 7 por del me vendim

NDËRMARRJA SHËRBYESE PUBLIKE ENTERPRISE SERVICE PRISHTINE 2010

duke pretenduar qe ne e kemi dorzuar vetem **1** certifikate dhe ajo ka qene me date te gabuar qe kinse ne kemi tentuar ta vëme ne lajthitje Komisionin Vlersues ,per ne kjo eshte e papapranueshme dhe diskriminuese dhe shihet qarte qe AK nuk deshiron te perfill as oferten as kerkesen tone per Rishqyrtim ,

OE N.SH CMD , dorëzon ankesë pranë OSHP-se, me anë të së ciles do të sqarojmë dhe faktojmë pretendimet tona lidhur me shkeljet e bera nga AK ne kete aktivitet te prokurimit publik. Ne po i drejtohemi OSHP-se duke kerkuar te drejten tone ligjore , te parandalojme shkelje te ligjit, dhe demtimin e buxhetit te shtetit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin,krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të:

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosoves, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të I referohemi LPP-së) dhe atë;

Nenit 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenit

7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Nenit 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Nenit 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,

Nenit 69 Aftesia teknike dhe ose PROFESIONALE

Nenit 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

NDËRMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE PRISHTINE 2010

II. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

Neni 39, Sqarimi i tenderëve.

1. Të dispozitave të LPP-së.

Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për te eliminuar ofertën e N.SH CMD nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se tenderi i kësaj kompanie është i papërgjegjshëm në kuptim te dispozitave te LPP-së, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të LPP-së.

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 6. paragrafi 1 te këtij ligji:

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Nëse i referohemi procesverbalit të hapjes së tenderit do të shohim se çmimi i ofertuar i ofertës së NSH CMDështë 7,500.00 euro, është çmimi më i ultë në raport me çmimin e OE Incormatika Computers SH.P.K, të propozuar për kontratë i cili është; 8,500.00 Euro.

Pretendojmë se AK, me vendimin e vet për eliminim të OE: NSH CMD nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit dhe me marrjen

e Vendimit për shpërblim të kontratës për OE Incormatika Computers SH.P.K, me vlerë të kontratës 8,500.00 euro i cili për

nga çmimi është më i shtrenjtë në vlerë prej <u>1,000.00</u>, ka vepruar në kundërshtim me obligimin ligjor që buron nga neni 6 i LPP-së i cili decidivisht obligon AK-në, që të siguroj që fondet publike dhe burimet tjera publike të përdoren në mënyrën efikase, racionale dhe ekonomike dhe jo të dëmtohet buxheti apo financat publike.

NDËRMARRJA SHTETËRORE E SHËRBIMEVE TË NDËRMARRJES PRISHTINË 2010 ENTERPRISE SERVICE

Nenit 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet që OE: Incormatika Computers SH.P.K , të shpërblehet me kontratë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së në RK, duke favorizuar ofertën e këtij operatori dhe duke diskriminuar operatoret tjerë pjesëmarrës në tender.

Pabarazia në trajtim si dhe favorizimi i një operatori si dhe diskriminimi i operatoreve tjerë është bërë nga ana e AK në procedurën e kualifikimit dhe përzgjedhjes së OE dhe me rastin e shpërblimit të kontratës. Ligji parasheh obligimin e çdo Autoritet kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurës se vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve që ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminues dhe do të veprojë në mënyrë transparente, si dhe eliminimin

e praktikave, kritereve ,kerkesave dhe specifikimeve teknike qe diskriminojnë ¨ në favor ose kundër një¨ ose më shumë kritereve, operatoreve ekonomik.

Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi,

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NSH CMD", si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhojë e kësaj të merr vendim për eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 59, paragrafin 2, dhe 4 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, **AK, duke mos gjetur ndonjë mangësi në dokumentacionin e prezentuar, edhe pse nuk ka kerkuar dok. shtese per sqarim , nga ana jonë, ka vlerësuar pa kurrfarë kriteri duke shkelur të gjitha dispozitat ligjore në këtë NEN dhe merr vendimin arbitrar (në fakt skandaloz) për refuzimin dhe eleminimin tone nga ky proces,**

Në vijim po citoj dispozitat e nenit 59. paragrafi 2 dhe 4 të këtij ligji:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet

CMD ENTERPRISE SERVICE NDËRMARRJA SHËRBYESE PRISHTINË 2010

ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i)përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, cfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij nen ligji

në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i N.SH CMD është i pa përgjegjshëm sepse tenderi i parashtrues I ofertes është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në DT.

Te ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OE janë të përcaktuara në Njoftimin per kontrate dhe ne

FDT te dosjes së tenderit.

a. eshte ne pajtueshmeri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosje të tenderit

b. eshtjej pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në këtë dosje të tenderit.

c. eshte dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në DT.

Duke u bazuar në Letrën standarde të tenderuesit të eliminuar të dërguar nga AK shohim se AK ka marrë vendim për eliminim nga aktiviteti i mëtejmë i prokurimit me arsyetimin se **kinse Nuk** I kemi plotësuar keto dy kritere :

Kërkesa nr1. Të jetë IT Profesional i çertifikuar Database SQL nga Microsoft

Kërkesa nr2. Të këtë trajner të çertifikuar për trajnim te stafit në program sipas DT dhe paisjen me çertifikatë për aftësim professional:

NDËRMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE
cmd
PRISHTINE 2010

Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56, paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 të LPP-së në Republikës së Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

;ë pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligii;

;ë dyti vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Pretendojme se AK ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 56 te LPP-se gjate procedures së vlersimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit në kualifikimin dhe ne përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesemarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në FDT e dosjes se tenderit.

Neni 69, Aftesia teknike dhe / ose profesionale,

NDËRMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE PRISHTINË 2010

Ne si kompani kemi plotësuar të gjitha kërkesat TEKNIKE dhe Profesionale,

të cilat i keni caktuar vetë ju si AUTORITET KONTRAKTUES.,

Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e kompanisë NSH" CMD "si oferte e pa përgjegjshme dhe si rrjedhojë e kësaj të marr vendim për eliminimin nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit ka vepruar në kundërshtim me neni 72, paragrafin 1, 2, te LPP-se ne Republikën e Kosovës. LPP obligon Autoritetin kontraktues qe ne rastet kur OE nuk ofron dokumente specikike AK duhet të ftoj operatoret ekonomik për te plotësuar apo qartësuar çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenin 65-71 të LPP-së

Citoj dispozitat e nenit 72 te LPP-së;

Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotesojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur Brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe e transparencës.

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Sigurimi i informacionit ge mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Duke u bazuar në Letrën standarde të tenderuesit të eliminuar të dërguar nga Autoriteti Kontraktues, si dhe obligimin e përcaktuar në bazë të nenit 72 të LPP-se, për të ftuar OE për të plotësuar apo sqaruar dokumentet të cilat ekzistenca e tyre

është fiksuar, pretendojmë se AK përmes Komisionit për vlerësimin krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 72 të LPP-së.

NDËRMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE PRISHTINE 2010

II. Dispozitat e Rregullave dhe Udhëzuesit operativ të prokurimit publik

Neni 39, Sqarimi i tenderëve

Pretendojmë se AK ka bërë shkelje te dispozitave të nenit 39, te Rregullave dhe UOPP, duke anashkaluar obligimin e parashtrimit të Kërkesës për Sqarim te tenderit në rast se OE nuk ka ofruar dëshmi te mjaftueshme mbi plotësimin e kërkesave te përcaktuara ne baze te nenit 65-71 te LPP-se.

Sipas nenit 39 të Rregullave dhe UOPP . Autoriteti kontraktues duhet të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE

Citoj dispozitat e nenit 39 te Rregullave dhe UOPP:

39.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të gartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 81 ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE"

Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura pretendojmë se AK, ka bërë shkelje

të dispozitave të nenit 39 të Rregullave dhe UOPP.

Prandaj, OSHP të anulojë vendimin e AK dhe të shpallë fitues kompaninë N.SH CMD

rrjedhimisht Oferten me cmim më të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmi material i shkaktuar, na krijon humbjen e besimit në AK dhe dekurajim per mospjesmarrje ne tendera te tjere te Prokurimit publik , qe ndikon direkt ne zvoglimin e konkurences , qe mund te jete edhe qellimi i AK me kete eleminim.

Dëmet tjera materiale, do të analizohen më vonë në rast se AK nuk pranon të na shpallë fitues si dhe demet e shpenzimeve te resurseve humane dhe finanaciare per pergatitjen e ofertes,dhe kerkesave per rishqyrtim dhe ankeses.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NDERMARRJA SHËRBYESE CMD ENTERPRISE SERVICE
PRISHTINË 2010

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PPQDD111111111H

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	Zejnullah Fetahu B.I., Prishtinë, N. Terezë 40a Nr. 2, 10000 Prishtinë
Përshkrimi Opis Description	Ritender-Programi financiar,menaxherial dhe administrativ si dhe mirembajtja
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	NPL KASTRIOTI -24-3397-2-3-6
Shuma / Iznos Ammount	€ 7500 Euro 00 Ct Data / Datum / Date
Me fjalë / Rečima In words	
Xhirollogaria Broj žiroračuna Bank account	1000430070005756
Lëshuar nga Izdato od / Issued by	OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.